



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1492/1 Prot.

Tiranë, më 02 / 10 / 2019

V E N D I M

Nr. 138, Datë 02 / 10 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 36, datë 15.04.2019, të bërë nga A.H kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës” dhe “gjendjes familjare¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Që prej vitit 2000 ka qenë në marrëdhënie punësimi në detyra të ndryshme në administratën tatimore, fillimisht në strukturat e Tatimeve në Fier dhe prej vitit 2004 në DPT. Nga data 26.03.2010 është emëruar për shkak të ristrukturimit të institucionit në pozicionin specialiste, në Sektorin e Pajisjeve Fiskale dhe Deklarimit On-Line në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit në DPT. Në datë 26.03.2019 është njoftuar për të tërhequr vendimin dhe njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe daljen nga statusi i nëpunësit civil. Me daljen e VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, me anë të disa ankesave dhe e-mail-eve, ka kërkuar tek eprorët për lëvizje paralele pasi sektori ku ishte e punësuar do të shkurtohej dhe do të kalonte tek AKSHI, dhe administrata tatimore do të ristrukturohej. Në takimin tek zyrat e AKSHI-t i kanë thënë se aty ka vende për specialistë të teknologjisë së informacionit (IT) dhe nuk kanë nevojë për ekonomistë. Edhe pse është munduar që të rrinte tek administrata tatimore, përgjigjja e eprorëve ka qenë që të konkuronte tek Departamenti i Administratës Publike (DAP). Në datë 21.03.2019 (në ditën që i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës), ka konstatuar nga sistemi, që janë marrë në punë*

¹ Referuar Çertifikatës familjare nr. 014883022, datë 04.04.2019 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Farkë, ankuesja ka lindur në datë 16.09.1969 dhe është beqare.

punonjës të rinj. Ankuesja informon se, në mënyrë verbale ka dëgjuar se do largojnë nga puna të gjithë ata punonjës që kanë shumë vite në tatime dhe do të emërojnë punonjës të rinj, studentë të ekselencës. Ankuesja shprehet se administrata tatimore e kishte mundësinë që nëpërmjet ligjit të nëpunësit civil të bënte lëvizje paralele, por megjithë kërkesat e saja, nuk i kanë dhënë zgjidhje. Ankuesja pretendon se largimi i saj nga puna është bërë për shkak të moshës dhe gjendjes civile pasi është beqare dhe jeton me prindërit e moshuar me të ardhura minimale”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në pozicionin e punës².

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 36, datë 15.04.2019, të bërë nga A.H u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

² Kërkesë e bërë gjatë seancës dëgjimore, datë 25.06.2019, min 60.03.

- Me shkresën nr. 577/1, datë 19.04.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga DPT për ankesën e bërë nga A.H si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituarat:
 - Kopje të procedurës së emërimit dhe largimit nga detyra të punonjësës A.H.
 - Numrin e punonjësve për të cilët është bërë lëvizja paralele në përfundim të procesit të ristrukturimit.
 - Kopje të strukturës dhe organikës së vjetër të DPT, strukturës dhe organikës së re të DPT dhe strukturës dhe organikës së AKSHI-t.
 - Numrin e punonjësve që janë punësuar në DPT nga data 21.03.2019 deri më sot.

Me shkresën nr. 8329/1, datë 14.05.2019, DPT në mes të tjerash informoi se: *“A.H me shkresën nr.3350/595, datë 26.03.2010, në zbatim të procedurave të ristrukturimit, është emëruar në pozicionin Specialiste në Sektorin e Pajisjeve Fiskale dhe Deklarimit on-line, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në DPT. Me shkresën nr.6144/1, datë 21.03.2019, A.H i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me Administratën Tatimore Qendrore, në zbatim të Vendimit nr.6144, datë 21.03.2019, të Komisionit të Ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore. Për periudhën 21.03.2019–Maj 2019, në Administratën Tatimore Qendrore, janë përzgjedhur 56 studentë të ekselencës, për të ushtruar detyra funksionale, pranë strukturave të përcaktuara nga Departamenti i Administratës Publike, për të cilët kanë filluar marrëdhëniet financiare. Në zbatim të VKM-s nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e AKSHI”, të Urdhrit nr.49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të Urdhrit nr.106, datë 21.03.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e organigramës dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” numri i pozicioneve të punës në Administratën Tatimore Qendrore, reduktohet me 57 pozicione të cilat kalojnë në përbërje të AKSHI-t. Pretendimi i A.H se është larguar nga shërbimi civil nuk qëndron pasi, referuar nenit 50 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Urdhrit nr. 49, datë 27.02.2019 të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të Urdhrit nr.106, datë 21.03.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e organigramës dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, struktura ku A.H ushtronte detyrat funksionale, është suprimuar. Në zbatim të Vendimit nr.673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e AKSHI”, funksionet e menaxhimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit do të kryhen nga njësitë organizative në përbërje të AKSHI-t. Në pikën 23 të VKM-së së sipërpërmendur, përcaktohet se punonjësit aktualë të njërive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit, në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, kalojnë tek AKSHI dhe do të trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, apo Kodit të Punës. Sa më sipër, me*

Vendimin nr. 6144, datë 21.03.2019 të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil me A.H, sipas nenit 50 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Sqarohet se, nuk jemi përpara faktit të largimit nga shërbimi civil. Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, mirëpërcakton largimin nga shërbimi civil të një nëpunësi civil, si masë ndëshkimore, disiplinore. Pretendimi i A.H, se pas largimit nga Administrata Tatimore Qendrore, janë emëruar punonjës të rinj, nuk qëndron pasi, referuar ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar, përcaktohen procedurat ligjore për emërimin në pozicione pune të punonjësve të rinj. Sqarohet se, punonjësit e rinj, për të cilët pretendohet, janë studentë të ekselencës të përzgjedhur për punësim në Administratën Shtetërore. Procedura për emërimin e tyre, me kontratë pune me afat të përcaktuar, ka filluar në vitin 2018, si dhe është prioritet i Qeverisë Shqiptare. Referuar VKM-së nr.766, datë 26.12.2018, DPT, është e detyruar të zbatojë për sa përcaktohet. DPT-ja shpjegon se, pretendimi i A.H, se është diskriminuar për shkak të moshës dhe gjendjes familjare, është i pabazuar, pasi Komisioni i Ristrukturimit, ka zbatuar me korrektësi dispozitat ligjore në fuqi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e tij dhe siç shpjegohet në shkresën e DAP-it, nr.1791/1, datë 09.04.2019, e gjithë Drejtoria e TIK e DPT, transferohet pa asnjë ndryshim në strukturën e AKSHI-t, duke përfshirë edhe pozicionin e Specialistit të Pajisjeve Fiskale”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 36, datë 15.04.2019, Komisioneri me shkresën nr. 577/3, datë 17.06.2019 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 24.06.2019. Për shkak të pamundësisë³ së palës ankuese për të qënë prezent në këtë datë, Komisioneri me shkresën nr. 577/4, datë 19.06.2019 njoftoi palët që seanca dëgjimore të shtyhej për ditën e Martë, më datë 25/06/2019, ora 13⁰⁰.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, A.H dhe avokatit të saj dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësues me autorizim⁴ E.P të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues deklaroi⁵ se ka komunikuar verbalisht me strukturat e DPT për qëndrimin e saj në marrëdhënie pune, pranë DPT, por përgjigjja që ka marrë ka qënë se

³ Referuar e-mailit të dërguar nga A.H në adresën: info@kmd.al, më datë 19.06.2019.

⁴ Me shkresën, nr. 12336, datë 24.06.2019.

⁵ Referuar deklaratimit gjatë seancës dëgjimore, min 05.42.

nuk ka vende pune pranë DPT dhe duhet të konkurojë pranë DAP-it. Ankuesja theksoi⁶ se ishte mbledhur Komisioni i Ristrukturimit dhe ajo nuk ishte njoftuar për procesin e ristrukturimit, sipas legjislacionit në fuqi. Ankuesja deklaroi⁷ se në datë 25-26.03.2019 ka marrë njoftimin për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil, ndërkohë që në datë 21.03.2019, në DPT janë bërë emërimet të reja, duke shtruar pyetjen se si u gjetën vendet e reja të punës për të rinjtë, duke qenë se ajo ishte e punësuar, me statusin e nëpunësit civil, me përvojë pune dhe nuk mbahej në punë. A.H u shpreh⁸ se nga 57 punonjës të DPT, janë transferuar tek AKSHI 43 punonjës. A.H informoi⁹ se janë të paktën dy punonjës (F.B dhe A.F) të Drejtorisë Rajonale Elbasan që ishin në kushte të njëjta me ankuesen që ishin në listën e transferimit dhe nuk janë transferuar tek AKSHI, por janë sistemuar në sektorë të tjerë. Ankuesja deklaroi¹⁰ se ishte njoftuar nga AKSHI për tu paraqitur, për të firmosur kontratën e punës, por ajo nuk ka pranuar sepse donte të mbronte statusin e nëpunësit civil.

Nga ana e përfaqësues së DPT, fillimisht u prezantua procedura dhe baza ligjore e procesit të ristrukturimit të DPT. Nga ana e përfaqësueses së DPT u deklarua¹¹ se në kuadër të ristrukturimit, nga DPT janë deklaruar 57 pozicione pune plan që ushtrojnë funksione të IT-s, nga këto 25 pozicione në drejtorinë e përgjithshme dhe 32 në drejtoritë rajonale. Nga këto 57 pozicione pune plan janë transferuar 43 punonjës fakt, pasi pjesa tjetër e vendeve të punës kanë qenë vakant dhe procedura për plotësimin e këtyre vendeve do bëhej nga AKSHI. Përfaqësuesja e DPT, informoi¹² se duke marrë shkas nga në një memo të bërë nga ankuesja dhe A.D (në datë 08.05.2018), DPT i është drejtuar me shkresën, nr.14943, datë 19.07.2018, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke e informuar se brenda strukturave të IT funksionojnë dhe struktura të pajisjeve fiskale që shtrijnë funksione të fushës së ekonomisë dhe këto pozicione të mos suprimohen dhe të kalonin tek AKSHI, por të qëndronin në DPT. Në përgjigje të kësaj shkrese, MFE me shkresën nr.14036/1, datë 30.07.2018, ka informuar se përcaktimi për transferimin e punonjësve të strukturave të IT është vlerësuar nga DAP-i në bashkëpunim me AKSHI-n dhe DPT dhe aktualisht kërkesa është e pamundur të realizohet. Gjithashtu, përfaqësuesja e DPT, deklaroi¹³ se para se të zbardheshin vendimet e komisionit të ristrukturimit nga ana e A.H nuk është depozituar asnjë kërkesë zyrtare, në të cilën të kërkonte lëvizje në vendet vakante që mund të kishte në administratën tatimore qendrore. Lidhur me pretendimin e A.H se janë emëruar punonjës të rinj në DPT, përfaqësuesja e DPT deklaroi¹⁴ se në zbatim të VKM nr. 766, datë 26.12.2018, DPT është njoftuar për dhënien e informacionit mbi vendet vakante të kategorisë ekzekutive, dhe në zbatim të kërkesave të një organi epror kanë vënë në dispozicion 48 vendet vakante të nivelit ekzekutiv, që janë me status të nëpunësit civil në të gjithë DPT, ndër këto rreth 20 vende vakante ishin në Drejtorinë e Përgjithshme dhe sipas

⁶ Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 07.30.

⁷ Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 06.05.

⁸ Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 08.01.

⁹ Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 46.10.

¹⁰ Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 13.05 dhe 26.35.

¹¹ Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 22.15.

¹² Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 23.50.

¹³ Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 31.08.

¹⁴ Referuar deklarimit gjatë seancës dëgjimore, min 31.25 dhe 32.40.

përshkrimeve të punës të gjitha pozicionet e punës janë të miratuar me kriter arsimor, shkenca ekonomike ose juridike. Në vijim DAP me shkresën nr.5140, datë 08.03.2019 ka informuar DPT për emërimin e 48 studentëve të ekselencës të përcaktuar për tu punësuar pranë administratës tatimore me kontratë me afat 1-vjeçar, që do të thotë se DPT nuk ka kryer procedura rekrutimi apo transferimi, pasi nuk ka patur vende vakante, por ka bërë sistemimin e këtyre punonjësve sipas pozicioneve të përcaktuara nga DAP-i. Lidhur me pretendimin e ankueses se janë mbajtur në punë punonjësit, F.B, A.F e të tjerë, përfaqësuesja e DPT deklaroi¹⁵ se nuk kishte një përgjigje konkrete për personat por theksoi se nëse pretendimi i A.H ishte për tu punësuar në drejtoritë rajonale duhet ta kishte parashtruar, si dhe shpjegoi se në drejtoritë rajonale, strukturat e IT nuk janë drejtori por janë sektorë të pajisjeve fiskale, IT dhe statistikës, dmth një sektor përmbledhë disa pozicione, ndërsa në drejtorinë e përgjithshme, drejtoria e IT ka sektorë të ndarë. Gjithashtu, përfaqësuesja e DPT, shpjegoi¹⁶ se në kushtet e mungesës së personelit në drejtoritë rajonale, mund të ketë ndodhur që një punonjës i pjesës së statistikës të jetë sistemuar në një pozicion tjetër pune.

- Në vijim të procedurës dhe kërkesave të lëna gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, subjekti ankues me shkresën datë 26.06.2019, protokolluar me tonën nr. 577/5, datë 27.06.2019, ka shpjeguar dhe njëherë pretendimet e saj, duke i bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin shkresor të komunikimit të saj me institucionet, si dhe shkresën datë 05.04.2019, njoftim për diskriminim për shkak të moshës, drejtuar DPT. Gjithashtu, ankuesja me e-mail-in datë 04.09.2019 ka dërguar listën e notave të shkollës së lartë dhe Vendimin nr. 2657, datë 22.07.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
- Në vijim të procedurës dhe kërkesave të lëna gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e DPT me e-mail-in, datë 02.07.2019, ka dërguar dokumentet e mëposhtëm: “-Urdhërin nr. 20, datë 11.03.2019 të DAP-it “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të administratës tatimore qendrore”; - Shkresën nr. 7343/1, datë 17.04.2019, kthim përgjigje njoftimit për diskriminim nga DPT; -Komunikimin elektronik, datë 30.08.2018, mbi njoftim për situatën/procedurat dhe kërkim të opinioneve të eprorëve të strukturave (Drejtorit të Drejtorisë së TIK)”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankueses për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil dhe mostransferimin e saj në një pozicion tjetër, për shkak të moshës dhe gjendjes familjare.

¹⁵ Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 46.35.

¹⁶ Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 49.25.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1 dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative¹⁷, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast DPT, e cila duhet të provojë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej saj.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

A.H prej vitit 2000 ka qenë në marrëdhënie punësimi në detyra të ndryshme në administratën tatimore, fillimisht në Drejtorinë e Tatimeve Fier dhe prej vitit 2004 është transferuar në DPT. A.H me shkresën nr.3350/595, datë 26.03.2010, në zbatim të procedurave të ristrukturimit, është emëruar në pozicionin Specialiste në Sektorin e Pajisjeve Fiskale dhe Deklarimit on-line, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në DPT. Me Vendimin nr. 1162, datë 21.11.2016, në zbatim të procedurave të ristrukturimit, është transferuar në pozicionin Specialist, në Sektorin e

¹⁷Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Pajisjeve Fiskale në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në DPT. Në kuadër të riorganizimit me VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e AKSHI”, të Urdhrit nr.49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të Urdhrit nr.106, datë 21.03.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e organigramës dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” numri i pozicioneve të punës në Administratën Tatimore Qendrore, është reduktuar me 57 pozicione të cilat kalojnë në përbërje të AKSHI-t. Në zbatim të legjislacionit të mësipërm, DAP ka nxjerrë Urdhrin nr. 20, datë 11.03.2019, për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore. Komisioni i Ristrukturimit, i ngritur pranë DPT, me Vendimit nr.6144, datë 21.03.2019 ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të A.H. Me shkresën nr.6144/1, datë 21.03.2019, DPT ka njoftuar A.H, për ndërprerjen e marrëdhëniet financiare, si dhe trajtimin e saj sipas pikës 7, të nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Me shkresën nr. 1726/1, datë 21.03.2019 të DAP-it, është njoftuar AKSHI dhe ankuesja, për fillimin e procedurave për vijimin e marrëdhënieve të punës në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore. Me e-mail-in datë 03.04.2019 A.H ka njoftuar AKSHI-n se po ndjek procedurën ligjore për moshumbjen e statusit të nëpunësit civil.

Referuar kronologjisë së ngjarjeve dhe akteve shkresore të dosjes së ankueses, rezulton se:

- Pas daljes së VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e AKSHI-t”, në datë 08.05.2018, me anë të një memoje të bërë nga ankuesja dhe A.D, i janë drejtuar Drejtores së Burimeve Njerëzore në DPT, në të cilën kanë shpjeguar detyrat dhe rëndësinë e Sektorit të Pajisjeve Fiskale, dhe kanë shprehur mendimin se ai sektor duhej të transferohej brenda një drejtorie tjetër në DPT.
- DPT me shkresën, nr.14943, datë 19.07.2018, i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke e informuar se brenda stukturave të IT funksionojnë dhe struktura të pajisjeve fiskale që shtrijnë funksione të fushës së ekonomisë dhe këto pozicione të mossuprimohen dhe të kalonin tek AKSHI, por të qëndronin në DPT.
- Në përgjigje të shkresës së mësipërme, MFE me shkresën nr.14036/1, datë 30.07.2018, ka informuar se përcaktimi për transferimin e punonjësve të strukturave të IT është vlerësuar nga DAP-i në bashkëpunim me AKSHI-n dhe DPT dhe aktualisht kërkesa është e pamundur të realizohet, dhe rivlerësimi i nevojave për personel të shtuar do të ishte objekt diskutimi gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit për vitin 2019.
- Referuar deklarimeve të bëra nga përfaqësuesja e DPT në seancën dëgjimore, provohet se DPT¹⁸, ka pasur 48 vende vakante të nivelit ekzekutiv, me status të nëpunësit civil, ndër këto rreth 20 vende vakante, kanë qenë në Drejtorinë e Përgjithshme.

Lidhur përsa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka qenë në dijeni të interesit të A.H për të qëndruar në marrëdhënie punësimi pranë DPT, dhe të ruante

¹⁸ Në kuadër të zbatimit të VKM nr. 766, datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019”.

statusin e nëpunësit civil, që prej datës 08.05.2018, kur i është drejtuar me memo strukturave të DPT.

Gjithashtu, me anë të korrespondencës elektronike, datë 30.08.2018, mes Drejtorit të Drejtorisë së TIK dhe Drejtores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT, dhe korrespondencës mes DPT dhe MFE, provohet se strukturat e DPT e kanë konsideruar të drejtë dhe teknike që Sektori i Pajisjeve Fiskale, në të cilën ishte e punësuar dhe ankuesja, ti bashkëngjitej një drejtorie tjetër.

Në këtë kuadër, Komisioneri vlerëson se DPT ka qenë në dijeni të interesit të ankueses për të qëndruar në marrëdhënie pune, në pozicion me status të nëpunësit civil, gjithashtu DPT vetë ka vlerësuar se Sektori i Pajisjeve Fiskale duhet të ishte pjesë e DPT, po ashtu ka pasur dhe vende vakante pranë Drejtorisë së Përgjithshme. Pavarësisht sa më lart, DPT ka dështuar për të transferuar apo mbajtur në marrëdhënie punësimi A.H, duke u justifikuar me faktin se nuk ka pasur një kërkesë nga ankuesja për tu transferuar në një pozicion tjetër brenda strukturave të DPT.

Lidhur me sa më sipër, bazuar në dokumentacionin dhe deklaratat e palëve, Komisioneri vlerëson se ankuesja deri në datë 26.03.2019, datë kur është vënë në dijeni të shkresës nr. 6144/1, datë 21.03.2019 “Për ndërprerje të marrëdhënieve financiare të A.H”, nuk ka qenë në dijeni të përfundimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në mënyrë që të kishte mundësi që të formalizonte kërkesën e saj për qëndrimin në marrëdhënie punësimi pranë DPT. Në dokumentet e shqyrtuar nuk ekziston asnjë dokument që të provojë se ankuesja është njoftuar nga ana e DPT, për fillimin e procesit të ristrukturimit, sipas procedurës së pikës 7, të nenit 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në të cilin shkruhet se: *“Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure.....”*.

Lidhur me pretendimin e ankueses, të bërë gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, se janë të paktën dy punonjës (F.B dhe A.F) të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan që ishin në kushte të njëjta me ankuesen që ishin në listën e transferimit dhe nuk janë transferuar tek AKSHI, por janë sistemuar në sektorë të tjerë, DPT nuk solli asnjë informacion për të vërtetuar të kundërtën e këtij pretendimi. Nisur nga fakti se në DPT kishte 48 vende vakante dhe DPT do lidhte kontrata të përkohshme të punës me studentë të ekselencës, tregon se DPT kishte pozicione pune vakante, pjesë e nëpunësit civil, dhe kishte mundësi që të transferonte A.H në një pozicion tjetër pune, brenda stukturës së DPT.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se DPT ka barrën e provës¹⁹ të provojë, që procesi i ristrukturimit dhe i transferimit të punonjësve të DPT, ka qenë i barabartë për të gjithë punonjësit.

¹⁹Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: *“2.Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se A.H, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shkak të moshës dhe gjendjes familjare.

Për sa më lart, Komisioneri duke konsideruar se DPT ka patur mundësinë për sistemimin e A.H në një pozicion tjetër pune pranë strukturave të saj, konstaton se ajo është trajtuar në mënyrë të padrejtë, duke mos u njoftuar për procesin e ristrukturimit si dhe të pabarabartë duke u trajtuar ndryshe nga kolegët e saj që u transferuan në pozicione të tjera brenda strukturave të DPT.

Lidhur me pretendimin e ankueses se janë emëruar punonjës të rinj gjatë vitit 2019, Komisioneri vlerëson se, procesi në zbatim të VKM nr. 766, datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019”, është një proces që nuk është zhvilluar nga strukturat e DPT por nga Departamenti i Administratës Publike, dhe nuk ka lidhje me procesin e ristrukturimit të DPT apo përfundimit të marrëdhënieve të shërbimit civil, të A.H.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën e subjektit ankues, pretendohet diskriminim, për shkak të “moshës” dhe “gjendjes familjare”, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

“Mosha” dhe “gjendja familjare”, janë shkaqe, për të cilët, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, rezulton se ankuesja është beqare, e datëlindjes 16.09.1969, pra rreth 50 vjeç dhe jeton me prindërit e moshuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me shkakun e mbrojtur.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesja është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana DPT, nëpërmjet mosnjoftimit lidhur me procesin e

mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

ristrukturimit si dhe duke u trajtuar ndryshe nga kolegët e saj që u transferuan në pozicione të tjera brenda strukturave të DPT.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se DPT, ishte në dijeni të interesimit të ankueses për të vazhduar marrëdhëniet e punësimit pranë DPT. Por dështimi i strukturave të DPT, për të vënë në dijeni ankuesen në kohën e duhur, për fillimin e procesit të ristrukturimit dhe përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, i mohuan ankueses të drejtën të kishte mundësi të kërkonte zyrtarisht, për të ruajtur pozicionin e punës, me status të nëpunësit civil, brenda DPT. Si pasojë e veprimeve të DPT, rezultoi që ankuesja të mos pranonte lidhjen e marrëdhënies të punës me AKSHI-n, sipas Kodit të Punës dhe të humbte statusin e nëpunësit civil, status për të cilin ankuesja kishte investuar përkushtimin e saj për zhvillimin e karrierës.

Gjatë shqyrtimit të fakteve dhe provave të administruara, rezultoi se ankuesja menjëherë sapo ishte vënë në dijeni të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, në datë 26.03.2019, ka bërë përpjekjet maksimale për ta kundërshtuar këtë vendim, duke iu drejtuar të gjitha institucioneve, me shkresat si vijon: -Shkresë datë 29.03.2019, drejtuar DAP dhe KMSHC; - Shkresë, Kthim përgjigje, datë 15.04.2019 drejtuar DAP; -Njoftim për diskriminim, datë 05.04.2019, drejtuar DPT; -Njoftim për pezullim të vendit të punës, datë 05.04.2019, drejtuar AKSHI-t; dhe -Kërkesë Padi, datë 05.04.2019 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën në mes të tjerash ka kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ, Vendimin nr. 6144, datë 21.03.2019 të Komisionit të Ristrukturimit të DPT.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjatë procesit të ristrukturimit duhet të kishte kryer dhe një vlerësim personal dhe profesional të çdo punonjësi që prekej nga ky proces dhe duhet të kishte marrë parasysh dhe pasojat sociale që do të sillte vendimmarrja e saj, duke shteruar çdo mundësi risistemimi në punë të punëmarrësve të cilëve iu ristrukturohej vendi i punës, në këtë rast të punonjësës A.H, e cila është beqare dhe bashkëjeton me prindërit e moshuar.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankueses se nuk është njoftuar për procesin e ristrukturimit dhe se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me punonjësit, F.B dhe A.F, dhe mos sistemimi i saj në strukturat e DPT nuk ka ardhur si pasojë e moshës dhe gjendjes familjare të ankueses. Përkundrazi, Komisioneri vlerëson se argumentimi i DPT, se përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil të ankueses për shkak të ristrukturimit, ka shërbyer vetëm si justifikim, për ta larguar atë nga strukturat e DPT.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast DPT. Pra, në këtë rast DPT, duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.”

Neni 3 i Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka përcaktuar se: *““Diskriminim i drejtëpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”*.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1²⁰, të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se ankuesja, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, trajtim i cili ka lidhje të drejtëpërdrejtë, me moshën dhe gjendjen familjare të ankuses.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

²⁰Në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, të shtetases A.H nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shkak të moshës dhe gjendjes familjare.
2. Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me A.H.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONER

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA